

## Promovimi i librit “UDHËKRYQET E PENSIONISTËVE TË KOSOVËS”



**Prishtinë, 6 shkurt 2012** - Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Kosovës (BSPK), më 1 shkurt 2012 organizoi promovimin e librit “UDHËKRYQET E PENSIONISTËVE TË KOSOVËS”, të autorit Fazli Kajtazi ku njëherit edhe e sponsoroi iniciativën e autorit për botimin, që në esencë hedhë në dritë tërë kompleksitetin e këtij problemi që kërkon zgjidhje. Promovimi i këtij libri u bë në prezencë të auditoriumit ku të ftuar ishin: Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) Nenad Rasic i cili mungonte, Fahri Buçinca kryetar i pensionistëve të Kosovës, Sylejman Meta redaktor i këtij libri, Fatmir Fehmiu anëtarë i shoqatës së pensionistëve etj.

Çështja e pensioneve dhe pensionistëve të Kosovës, është një ndër problemet më aktuale dhe shoqëria kosovare që 12 vite nuk po arrin të gjejë zgjidhje për këtë problem, që prek jetën e njerëzve më të pambrojtur të Kosovës, që ata dhe familjet e tyre përjetuan një tragjedi dhe gjenocid social. Haxhi Arifi kryetar i BSPK-së tha që duke e përkrahur promovimin e këtij libri BSPK –ja dëshiron të jap kontribut në identifikimin e problemeve me të cilat përballen pensionistët e Kosovës. Arifi potencoi që po punohet që nga zyret regjionale të BSPK-së nëpër komunat e Kosovës, me të gjitha degët anëtare të BSPK-së, e deri në nivelin më të lartë të organizimit sindikal, që të japin rekomandime konkrete dhe propozime adekuate në formë të

amendamenteve, që të finalizojnë Ligjin mbi Pensionet dhe të eliminohen zbrazëtitat dhe paqartësitë e sistemit pensional në Kosovë.

Fahri Buqinca- kryetar i Shoqatës së Pensionistëve të Kosovës, tha që ky libër ka bërë një përshkrim të gjendjes së pensionistëve në Kosovë duke filluar prej vitit 2002. Problemi i pensionistëve të Kosovës, është problem për të cilin mungon vullneti për tu zgjedhur por që autori në librin e tij ka dhënë edhe propozime se si do të mund të zgjidheshin këto probleme. Zgjidhjen e problemit të pensionistëve Kajtazi e shef nëpërmes sindikatës, shoqërisë së pensionistëve dhe përmes institucioneve të Kosovës e sidomos nëpërmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS).

Sylejman Meta, redaktor i këtij libri tha që autori i këtij libri ka thënë një të vërtetë të kohës duke bërë një përshkrim detal për padrejtësitë që i'u kanë bërë pensionistëve të Kosovës në të gjithë periudhat në të cilat kaluan ata. Në mënyrë kronologjike i ka përshkruar të gjitha aksionet, aktivitetet, ligjet për zgjedhjen e çështjes së pensionistëve.

Z. Metaj konsideron se ky libër është një material i mjaftueshëm për zgjidhjen e problemeve të pensionistëve. Metaj konsideron se problemi i pensionistëve ka ngel si një gjenocid i hapur dhe i heshtur social. Njëherit Meta falënderoi BSPK-në për kontributin e veçantë që dha për Botimin e këtij libri.

Ndërsa Fatmir Fehmiu, anëtarë i sindikatës së pensionistëve konsideron se zgjedhja e problemit të pensionistëve, nuk është çështje e vullnetit apo disponimit politik, por është çështje e respektimit të konventave ndërkombëtare. Fehmiu theksoi se e drejta për pension, është një e drejtë e ligjshme e drejtë kushtetuese, personale e cila nuk mund të tjetërsohet.

Përmbylljen e takimit e bëri kryetari BSPK-ës Haxhi Arifi, organizues i takimit i cili në fjalën përmbyllëse i ftoi pensionistë për bashkim forcash sepse rruëgtimi për realizimin e të drejtave të tyre do të ketë vështirësi dhe duhet të jenë unik dhe të bashkuar në një sindikatë. Krejt në fund të kësaj tryeze kryetari i BSPK-ës i ftoi pensionistët që në të ardhmen me BSPK-ën të kenë takime më të shpeshta. \*\*\*